

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9695, DATË 19.3.2007 “PËR PROCEDURAT E BIRËSIMIT DHE KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMIT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Hartimi i këtij projektligji lindi si nevojë pas vlerësimit të punës dhe të kriterëve të përzgjedhjes së kryetarit të Komitetit Shqiptar të Birësimit. Sipas kriterëve për emërimin e kryetarit të këtij Komiteti, të parashikuara në nenin 10, të ligjit në fuqi, kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e larta në shkencat juridike, niveli i diplomës “Master shkencor”. Nisur nga fakti që procedurat e birësimit kanë të bëjnë, në radhë të parë, me vlerësimin e fëmijës, të prindërve birësues, gjendjes së tyre morale, psikologjike dhe sociale, si dhe personelit aktual të Komitetit Shqiptar të Birësimit, ku janë të punësuar mjaftueshëm juristë, Ministria e Drejtësisë arriti në konkluzionin se fusha e përzgjedhjes së kryetarit të këtij Komiteti duhet të përfshijë edhe shkencat humane dhe ato sociale. Kjo do të krijonte mundësinë që edhe kandidatë nga këto fusha të aplikojnë për drejtimin e këtij komiteti.

II. VLERËSIM I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA

Projektligji nuk është përfshirë në programin analitik të akteve, por është në përputhje me objektivat e qeverisë shqiptare, në të cilat të drejtat dhe interesi më i lartë i fëmijës janë në qendër të vëmendjes. Ky detyrim për qeverinë shqiptare lind edhe nga neni 54 i Kushtetutës.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimi i propozuar në ligjin nr.9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, do të zgjerojë fushën e aplikantëve për pozicionin e kryetarit të komitetit dhe do të krijojë mundësinë për përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm. Në vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë theksohet se nuk ka arsye që si kriter i përzgjedhjes së kryetarit të këtij komiteti të jetë vetëm përfundimi i studimeve në shkencat juridike.

Procedura e birësimit udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, vlerësimi i të cilit, në një rast konkret, nuk mund të bëhet vetëm nga një jurist. Të aftë për të bërë një vlerësim të tillë janë edhe psikologët, punonjësit socialë apo edhe persona nga fusha të tjera të shkencave sociale. Në procedurat gjyqësore, në të cilat preken të drejtat e fëmijëve, janë këta persona që thirren nga gjykatat për dhënien e një mendimi të kualifikuar mbi gjendjen e fëmijës dhe të prindërve, raportet midis tyre, etj. Fakti tjetër, që pranë Komitetit Shqiptar të Birësimit janë të punësuar mjaftueshëm juristë, e bën të panevojshëm kufizimin e kriterëve të përzgjedhjes së kryetarit të Komitetit Shqiptar të Birësimit, duke përcaktuar si kriter për emërimin përfundimin e arsimit të lartë në shkenca juridike. Përmbajtja aktuale e pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr.9695, datë 19.3.2007, të ndryshuar, sipas vlerësimit nga Drejtoria e Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë bie ndesh me nenin 49 të Kushtetutës, pasi kufizon në mënyrë të pajustificuar dhe joobjektive të drejtën për të zgjedhur dhe ushtruar një funksion shtetëror. Arsyeja pse neni 10, i ligjit nr.9697/2007, u ndryshua në vitin 2015, duke përcaktuar si kriter përzgjedhjeje përfundimin e arsimit të lartë në shkencat juridike është e paqartë. Përmbajtja e nenit 10, sipas variantit të vitit 2007 vlerësohet më e plotë dhe në përputhje me nenin 54 të Kushtetutës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe është në përputhje me parimet kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi. Në veçanti theksohet përputhshmëria me nenet 49 dhe 54 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Nuk ka përafrim me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban vetëm dy nene.

Neni 1 përcakton nivelin dhe fushën shkencore të arsimimit të kryetarit të Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit sipas nenit 84 të Kushtetutës, 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ligji vlen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe çdo organ shtetëror ka detyrimin për zbatimin e tij.

VIII. MINISTRITË INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Drejtësisë, respektivisht, nga Drejtoria e Vlerësimit dhe Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, pasi ndryshohen vetëm kriteret e emërimit të kryetarit të Komitetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE